



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 53 datë 30.09.2024

“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT TË ZËRAVE NGA SHPENZIMEVE KORRENTE TEK PROJEKTET E INVESTIMEVE BRENDA TË NJËJTIT PROGRAM PËR VITIN 2024”

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 45 të Ligjit Nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar; ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të ndryshuar; ligjit Nr. 97, datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar; udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” të ndryshuar; Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave Nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”, VKB Nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar dhe si dhe dokumentacionin e përgatitur nga Drejtoria e Policisë Bashkiake.

VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga **Shpenzime Korrente tek Projektet e Investimeve**, brenda programit 03140 “Shërbimet e Policisë Vendore”, si më poshtë:
Pakësime viti 2024 lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Artikulli 602 Mallra dhe Shërbime	Institucioni Likuidues
1	03140 (kap.1)	Shërbimet e Policisë Vendore	P03140.Q1.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake.		Bashkia Shkodër

			A1.Blerje uniforma dhe radio, mirëmbajtje radio.	800,000	
Totali				800,000	

Shtesa viti 2024

lekë

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni Likuidues
1	03140 (kap.1)	Shërbimet e Policisë Vendore	P03140.Q1.O2.A2 Mbështetje dhe ofrimi shërbimit të transportit për funksionimin e Policisë Bashkiake. A. 5 Blerje Karrotreci	800,000	Bashkia Shkodër
Totali				800,000	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 30 vota

Vota Pro 30


Vota Kundër 11

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion ULLI



Adresa: Rr. "15 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al